



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**RREGULLORE Nr. 03/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES Nr. 02/2024 PËR KLASIFIKIMIN E VENDEVE TË PUNËS PËR
NËPUNËSIT CIVIL NË ADMINISTRATËN E SISTEMIT GJYQËSOR, E NDRYSHUAR
DHE PLOTËSUAR ME RREGULLOREN Nr. 24/2024**

Prishtinë, 24.07.2025

Këshilli Gjyqësor i Kosovës,

Në mbështetje të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 1 pika 1.24 të Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 2, paragrafi 3, nenit 6 paragrafit 4 dhe nenit 38 paragrafit 7, të Ligjit 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 2 paragrafit 3 dhe neni 42, paragrafi 4 i Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Aktgjykimit Nr. KO216/22 dhe KO220/22, si dhe Aktgjykimit Nr. KO79/23, të Gjykatës Kushtetuese, në mbledhjen e mbajtur me datë 24.07.2025,

Miraton:

RREGULLORE Nr. 03/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES Nr. 02/2024 PËR KLASIFIKIMIN E VENDEVE TË PUNËS PËR NËPUNËSIT CIVIL NË ADMINISTRATËN E SISTEMIT GJYQËSOR, E NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME RREGULLOREN Nr. 24/2024

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, e Ndryshuar dhe Plotësuar me Rregulloren Nr. 24/2024.

Neni 2

Në nenin 3, paragrafi 1, pika 1.8, të Rregullores bazë, pas fjalisë “zyrtarët publik”, shtohet fjalia me formulimin si vijon: “dhe aktet tjera të miratuara në Këshill”.

Neni 3

1. Në nenin 4, të Rregullores bazë, pas paragrafit 1, shtohen paragrafi 2 dhe 3, me tekstin si në vijim:

2. Përshkrimi i përgjithshëm për secilën kategori dhe klasë, përcaktohet sipas Katalogut për pozitat dhe përshkrimin e vendeve të punës, të cilat do të janë pjesë përbërëse të kësaj rregullore, e ku përfshihen:

- 2.1. katalogu i pozitave dhe përshkrimit të vendeve të punës për nëpunësit në Sekretariatën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- 2.2. katalogu i pozitave dhe përshkrimit të vendeve të punës për nëpunësit në

- Njësinë për Inspektim gjyqësor;
- 2.3. katalogu i pozitive dhe përshkrimit të vendeve të punës për nëpunësit në gjykatat e Republikës së Kosovës;
- 2.4. katalogu i pozitive dhe përshkrimit të vendeve të punës për nëpunësit në PZAP - Sekretariatit e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

3. Katalogët sipas paragrafit 2 të këtij neni, hartohen dhe miratohen, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore.

Neni 4

Neni 15, i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

Neni 15

Kategoritë e pozitive të nëpunësve në administratën e sistemit gjyqësor

1. Pozitat e punës për nëpunësit e Administratës së Sistemit gjyqësor, kategorizohen sipas LZP-së, dhe kësaj rregullore, por duke mos u kufizuar brenda një kategorie, duke marrë parasysh natyrën specifike të pozitive, emërtesave dhe klasave, dhe ndahen në këto kategori:

- 1.1. kategoria Drejtues/e i/e Lartë 1;
- 1.2. kategoria Drejtues/e i/e Lartë 2;
- 1.3. kategoria Drejtues/e i/e Mesëm 1;
- 1.4. kategoria Drejtues/e i/e Mesëm 2;
- 1.5. kategoria Drejtues i/e Ultë 1;
- 1.6. kategoria Drejtues i/e Ultë 2;
- 1.7. kategoria Inspektor/e dhe Ekspert/e Gjyqësore;
- 1.8. kategoria Bashkëpunëtor/e Profesional/e;
- 1.9. kategoria Ekspert/e Shtojca 14.4, Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik;
- 1.10. kategoria Profesional e cila ndahet në Profesional 1, Profesional 2 dhe Profesional 3;
- 1.11. kategoria teknik dhe administrativ; dhe,
- 1.12. kategoria zyrtar dhe nëpunës i Kabinetit.

Neni 5

Neni 16, i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

Neni 16

Përshkrimi i përgjithshëm i punës, klasat dhe emërtesat për kategorinë Drejtues/e i/e Lartë 1

1. Është udhëheqësi më i lartë administrativ në institucion, i cili për punën e tij i përgjigjet drejtpërdrejtë institucionit dhe titullarit të institucionit.
2. Kategoria Drejtues/e i/e Lartë 1 është përgjegjës për administrim efikas dhe efektiv të Sekretariatit të Këshillit.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore për Kategorinë Drejtues/e i/e Lartë 1 janë të rregulluara me Ligjin Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe aktet përkatëse normative të miratuara nga Këshilli.
4. Në kategorinë Drejtues/e i/e Lartë 1, bënë pjesë nëpunësi me emërtimin e pozitës si vijon:
 - 4.1. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit/Sekretariati i Këshillit.
5. Paga për kategorinë Drejtues/e i/e Lartë 1, përcaktohet sipas Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe aktet përkatëse të miratuara nga Këshilli.

Neni 6

Pas nenit 16, të Rregullores bazë, shtohet një nen i ri, me tekstin si në vijim:

Neni 16 A

Përshkrimi i përgjithshëm i punës, klasat dhe emërtesat për kategorinë Drejtues/e i/e Lartë 2

1. Është udhëheqës i lartë administrativ në institucion, i cili për punën e tij i përgjigjet drejtpërdrejtë institucionit dhe titullarit të institucionit.
2. Kategoria Drejtues/e i/e Lartë 2 është përgjegjës për administrim efikas dhe efektiv të Sekretariatit të PZAP-së dhe Njësisë.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore për kategorinë Drejtues/e i/e Lartë 2 janë të rregulluara me Ligjin Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe aktet përkatëse normative të miratuara nga Këshilli.

4. Në kategorinë Drejtues/e i/e Lartë 2, bëjnë pjesë nëpunësit me emërtime të pozitës si vijon:

4.1. Drejtori i Njësisë/Njësia për Inspektim Gjyqësor;

4.2. Drejtor i Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa/PZAP.

5. Paga për kategorinë Drejtues/e i/e Lartë 2, përcaktohet sipas Ligjit Nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe aktet përkatëse të miratuara nga Këshilli.

Neni 7

Neni 17 i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Neni 17

Klasifikimi i vendeve të punës për kategorinë Drejtues/e i/e Mesëm 1

1. Kategoria Drejtues/e i/e Mesëm 1, është përgjegjës për menaxhimin e një departamenti i cili është përgjegjës për formulimin, mbikëqyrjen e zbatimit të politikave, legjislacionit, dokumenteve strategjike, procedurave, standardeve, që aplikohen në Sekretariat, Sekretariat të PZAP-së, Njësi dhe në gjykata, ose koordinimin e proceseve të rëndësishme në gjyqësor.

2. Për fushat të cilat i menaxhon është përgjegjës për hartimin e raporteve për Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit, Drejtorin e Njësisë për Inspektim Gjyqësor, Drejtorin e Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe Kryetarin e Gjykatës përkatëse respektivisht Këshillin.

3. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunës dhe për punën e tij i përgjigjet mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë.

4. Në kategorinë Drejtues/e i/e Mesëm 1; Grupi: J; Klasa: J12; Koeficienti 12.3, bëjnë pjesë nëpunësit me emërtime të pozitës si vijon:

4.1. Drejtor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm/Këshill;

4.2. Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore/Sekretariat;

4.3. Drejtor i Departamentit për Logjistikë dhe Infrastrukturë/Sekretariat;

4.4. Drejtor i Departamentit për Buxhet dhe Financa/Sekretariat;

4.5. Drejtor i Departamentit për Prokurim/Sekretariat;

4.6. Drejtor i Departamentit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/Sekretariat;

4.7. Drejtor i Zyrës për Statistika/Njësia;

4.8. Drejtor i Zyrës për Vlerësim dhe Verifikim/Njësia;

4.9. Drejtor i Zyrës për Performancë dhe Inspektim/Njësia;

4.10. Drejtor i Zyrës për Disiplinim/Njësia;

- 4.11. Administrator i Gjykatës;
- 4.12. Drejtor i Departamentit Ligjor/PZAP;
- 4.13. Drejtor i Departamentit për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme/PZAP.

Neni 8

Nenit 3 i Rregullores Nr.24/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores bazë, fshihet nga teksti.

Neni 9

Neni 18, i rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Neni 18

Klasifikimi i vendeve të punës për kategorinë Drejtues/e i/e Mesëm 2

1. Në kategorinë Drejtues/e i/e Mesëm 2 përcaktohet pozita e Udhëheqësit të Zyrës/Divizionit, i cili është përgjegjës për fushën e caktuar të përgjegjësisë brenda departamentit ose institucionit.
2. Për fushat të cilat i menaxhon është përgjegjës për hartimin e raporteve për mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.
3. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunësi i cili për punën e tij i përgjigjet mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.
4. Në kategorinë Drejtues/e i/e Mesëm 2; Grupi J; Klasa J9, Koeficienti 9.4 bëjnë pjesë nëpunësit me emërtime të pozitës si vijon:

- 4.1. Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media/Këshill;
- 4.2. Udhëheqës i Zyrës për Integritet Evropian/Sekretariat;
- 4.3. Udhëheqës i Zyrës për Përkthime/Sekretariat;
- 4.4. Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Kontratave/Sekretariat;
- 4.5. Udhëheqës i Divizionit për Transport dhe Siguri/Sekretariat;
- 4.6. Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë dhe Furnizime/Sekretariat;
- 4.7. Udhëheqës i Divizionit për Administrim të Dokumenteve dhe Arkivë/Sekretariat;
- 4.8. Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje të Këshillit, Komisioneve dhe Paneleve/Sekretariat;
- 4.9. Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrje të Zbatimit të Akteve të Këshillit dhe për Përfaqësim Gjyqësor/Sekretariat;
- 4.10. Udhëheqës i Divizionit për të Hyra dhe Pasuri/Sekretariat;

- 4.11. Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa/Sekretariat;
- 4.12. Udhëheqës i Divizionit për Publikim dhe Vlerësim të Tenderëve/Sekretariat;
- 4.13. Udhëheqës i Divizionit për Rekrutimin dhe Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/Sekretariat;
- 4.14. Udhëheqës i Divizionit për Zbatimin e Politikave për Trajnime dhe Zhvillime të Burimeve Njerëzore/Sekretariat;
- 4.15. Udhëheqës i Zyrës për Mbështetje Juridike/Gjykatë;
- 4.16. Udhëheqës i Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve/Gjykatë;
- 4.17. Këshilltari Ligjor i cili vepron si Kreu i Njësisë/Gjykatë Komerciale;
- 4.18. Zëvendës administrator/Gjykatë;
- 4.19. Ndihmës administrator/degë e gjykatës;
- 4.20. Udhëheqës i divizionit për hartim të legjislacionit, mbështetje ligjore dhe shqyrtimin e ankesave në PZAP;
- 4.21. Udhëheqës i Divizionit për koordinim, bashkëpunim ndërinstitutional, mbikëqyrje dhe raportim në PZAP;
- 4.22. Udhëheqës i Divizionit për shërbime të përgjithshme dhe logjistike/PZAP.

Neni 10

Neni 4, 5 dhe 7 i Rregullores Nr.24/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores bazë, fshihen nga teksti.

Neni 11

Pas nenit 18, të Rregullores bazë, shtohet një nen i ri, me tekstin si në vijim:

Neni 18A

Klasifikimi i vendeve të punës për kategorinë Drejtues/e i/e Ulët 1

1. Në kategorinë Drejtues/e i/e Ulët 1 vendoset udhëheqësi i një divizioni i cili është përgjegjës për fushën e caktuar të përgjegjësisë brenda departamentit ose institucionit.
2. Për fushat të cilat i menaxhon është përgjegjës për hartimin e raporteve për mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.
3. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunës i cili për punën e tij i përgjigjet mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.
4. Në kategorinë Drejtues/e i/e Ulët 1; Grupi J; Klasa J13, Koeficienti 8.6, bëjnë pjesë nëpunësit me emërtime të pozitës si vijon:

- 4.1. Udhëheqës i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Media/Gjykatë;
- 4.2. Udhëheqës i Zyrës për Shërbime të Përbashkëta/Gjykatë;
- 4.3. Udhëheqës i Zyrës për Buxhet dhe Financa/Gjykatë;
- 4.4. Zyrtar Çertifikues/Sekretariat dhe gjykatë.

Neni 12

Neni 19, i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Neni 19

Klasifikimi i vendeve të punës për kategorinë Drejtues/e i/e Ulët 2

1. Në kategorinë Drejtues/e i/e Ulët 2 vendoset udhëheqësi i një sektori i cili është përgjegjës për fushën e caktuar të përgjegjësisë brenda departamentit ose institucionit.
2. Për fushat të cilat i menaxhon është përgjegjës për hartimin e raporteve për mbikëqyrësin e drejtëpëdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.
3. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunës i cili për punën e tij i përgjigjet mbikëqyrësit të drejtëpëdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.
4. Në kategorinë Drejtues/e i/e Ulët 2; Grupi J; Klasa J14, Koeficienti 7.5, bëjnë pjesë nëpunësit me emërtime të pozitës si vijon:

- 4.1. Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve/Gjykatë;
- 4.2. Mbikëqyrës i Sektorit për Ekzekutim, Arkivim dhe Statistika/Gjykatë;
- 4.3. Koordinator për Siguri/Sekretariat dhe gjykatë.

Neni 13

Neni 20, i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Neni 20

Klasifikimi i vendeve të punës për kategorinë Inspektor/e dhe Ekspert/e Gjyqësore

1. Në kategorinë Inspektor/e gjyqësor dhe Ekspert/e Gjyqësore vendosen pozitat e nivelit të lartë profesional me përgatitje specifike, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale.

2. Mbajtësit e këtyre pozitave kryejnë një sërë detyrash të natyrës komplekse ose specifike në mënyrë individuale, ose si udhëheqës ose anëtar i një ekipi, të cilët punojnë të pavarur brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave.

3. Për fushat të cilat është përgjegjës, harton raporte për mbikëqyrësin e drejtëpëdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.

4. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunës i cili për punën e tij i përgjigjet mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.

5. Në kategorinë Inspektor/e dhe Ekspert/e Gjyqësore; Grupi J; Klasa J9, Koeficienti 9.4, bëjnë pjesë nëpunësit e administratës së sistemit gjyqësor me emërtime të pozitës si vijon:

- 5.1. Inspektor/e gjyqësor/e/Njësi;
- 5.2. Hulumtues në Zyrën për Hulumtim, Publikim dhe Monitorim/Gjykatë Supreme;
- 5.3. Monitorues në Zyrën për Hulumtim, Publikim dhe Monitorim/Gjykatë Supreme;
- 5.4. Ekspert i Auditimit të Brendshëm/Këshill;
- 5.5. Zyrtar i lartë për Konstruksione/Sekretariat;
- 5.6. Zyrtar i lartë për Infrastrukturë/Inxhinier/Sekretariat.

Neni 14

Neni 21 i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Neni 21

Klasifikimi i vendeve të punës për kategorinë Bashkëpunëtor/e Profesional/e

1. Në kategorinë Bashkëpunëtor/e Profesional/e vendosen pozitat Bashkëpunëtor/e Profesional/e, Këshilltar/e Profesional/e, Zyrtar i Lartë për Përfaqësim gjyqësor, Koordinator i Panelit për Lirim me Kusht/Sekretariat dhe Zyrtar/e Inspektues/e, si pozita të nëpunësve me kompetencë profesionale që i ofrojnë mbështetje profesionale gjyqtarit, ndihmon në përgatitjen e memorandumeve, vendimeve të shkruara, aktgjykimeve, vendimeve të tjera, duke siguruar materiale të domosdoshme juridike dhe duke bërë shqyrtimin e ligjeve si dhe zyrtarët me kompetencë profesionale të cilët marrin pjesë në përfaqësime gjyqësore dhe në koordinimin e punëve të Panelit për Lirim me Kusht dhe Njësisë për Inspektim Gjyqësor.

2. Për fushat për të cilat është përgjegjës, harton raporte për mbikëqyrësin e drejtëpëdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.

3. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunës i cili për punën e tij i përgjigjet mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.

4. Në kategorinë Bashkëpunëtor Profesional; Grupi J; Klasa J10; Koeficienti 8.5, bëjnë pjesë nëpunësit me emërtime të pozitës si vijon:

- 4.1. Bashkëpunëtor profesional në Gjykatën Supreme;
- 4.2. Bashkëpunëtor profesional në Gjykatën e Apelit;
- 4.3. Bashkëpunëtor profesional në Gjykatën Komerciale;
- 4.4. Këshilltar profesional në Gjykatën Komerciale;
- 4.5. Bashkëpunëtor profesional/Sekretariat;
- 4.6. Zyrtar i lartë ligjor për përfaqësim gjyqësor/Sekretariat;
- 4.7. Koordinator i Panelit për Lirim me Kusht/Sekretariat.

5. Në kategorinë Bashkëpunëtor Profesional; Grupi J; Klasa J11; Koeficienti 7.14, bëjnë pjesë nëpunësit me emërtime të pozitës si vijon:

- 5.1. Bashkëpunëtorë profesional/Gjykatë Themelore dhe degët e tyre; dhe
- 5.2. Zyrtar/e inspektues/e /Njësia.

Neni 15

Neni 22, 24 dhe 25 i Rregullores bazë, fshihen nga teksti.

Neni 16

Neni 26, i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Neni 26

Klasifikimi i vendeve të punës për kategorinë Profesional 1

1. Në kategorinë Profesional 1, vendosen pozitat e nivelit të lartë profesional, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale në fushat dhe sektorët e caktuar. Mbajtësit e këtyre pozitave kryejnë një sërë detyrash të natyrës komplekse ose specifike në mënyrë individuale ose si udhëheqës ose anëtar i një ekipi. Mbajtësit e këtyre pozitave punojnë të pavarur brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave.

2. Për fushat për të cilat është përgjegjës, harton raporte për mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.

3. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunës i cili për punën e tij i përgjigjet mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.

4. Në kategorinë Profesional 1; Grupi J; Klasa J14, Koeficienti 7.5, bëjnë pjesë nëpunësit me emërtime të pozitës si vijon:

- 4.1. Zyrtar i lartë Ligjor/Sekretariat;
- 4.2. Zyrtar i lartë për Integritet Evropian/Sekretariat;
- 4.3. Zyrtar i datës bazë së SQEP/Sekretariat;
- 4.4. Zyrtar i lartë për evidencë Penale/Sekretariat;
- 4.5. Zyrtar i lartë i logjistikës/Sekretariat;
- 4.6. Zyrtar i lartë i Pasurisë/Sekretariat;
- 4.7. Zyrtar i lartë për Buxhet dhe Financa/Sekretariat;
- 4.8. Zyrtar i lartë i Prokurimit/Sekretariat;
- 4.9. Zyrtar i lartë për Statistika/Njësia;
- 4.10. Zyrtar i lartë i personelit/Sekretariat/PZAP;
- 4.11. Zyrtar për përkthime/Sekretariat/gjykatë/PZAP;
- 4.12. Zyrtar i lartë Ekzekutiv/PZAP;
- 4.13. Zyrtar i lartë për informim dhe komunikim/PZAP;
- 4.14. Zyrtar i lartë për hartim ligjor, shqyrtimin e ankesave dhe përgatitjen e paneleve/PZAP;
- 4.15. Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa/PZAP.

Neni 17

Neni 27, i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Neni 27

Klasifikimi i vendeve të punës për kategorinë Profesional 2

1. Në kategorinë Profesional 2, vendosen pozitat e nivelit profesional të administratës së sistemit gjyqësor, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të përgjithshme profesionale në fusha të caktuara. Puna kryhet brenda udhëzimeve specifike dhe praktikave të institucionit me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë me mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale të kohëpaskohshme nga mbikëqyrësi dhe zyrtari i nivelit më të lartë profesional.

2. Për fushat për të cilat është përgjegjës, harton raporte për mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.

3. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunësi i cili për punën e tij i përgjigjet mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.

4. Në kategorinë Profesional 2; Grupi J; Klasa J15, Koeficienti 5.85, bëjnë pjesë nëpunësit me emërtime të pozitës si vijon:

- 4.1. Referent/Sekretariat dhe gjykatë;
- 4.2. Zyrtar ligjor/Sekretariat dhe gjykatë;
- 4.3. Zyrtar për të Hyra gjyqësore/Arkëtar/Sekretariat dhe gjykatë;
- 4.4. Zyrtar për Arkivë/Arkivist/Sekretariat/Gjykatë;
- 4.5. Zyrtar për Menaxhimin e Kontratave/Sekretariat;
- 4.6. Zyrtar për Shpenzime/Sekretariat dhe gjykatë;
- 4.7. Zyrtar për Informim dhe Komunikim me Media/Sekretariat dhe gjykatë;
- 4.8. Lektor/Sekretariat dhe gjykatë;
- 4.9. Zyrtar i personelit/Sekretariat dhe gjykatë;
- 4.10. Zyrtar për Evidencë Penale/Sekretariat;
- 4.11. Zyrtar i logjistikës/Sekretariat dhe gjykatë;
- 4.12. Zyrtar për Buxhet dhe Financa/Sekretariat dhe gjykatë;
- 4.13. Zyrtar i Pasurisë/Sekretariat dhe gjykatë;
- 4.14. Zyrtar i Prokurimit/Sekretariat;
- 4.15. Zyrtar për statistika/Njësia dhe gjykatë;
- 4.16. Sekretare juridike/gjykatë;
- 4.17. Zyrtar për Hulumtime dhe Analiza ligjore të Kontesteve Zgjedhore/PZAP;
- 4.18. Zyrtar për Koordinim dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional/PZAP;
- 4.19. Zyrtar për Mbikëqyrje Ligjore dhe Raportim/PZAP;
- 4.20. Zyrtar për Arkiv/PZAP.

Neni 18

Neni 28, i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Neni 28

Klasifikimi i vendeve të punës për kategorinë Profesional 3

1. Në kategorinë Profesional 3, vendosen pozitat e nivelit profesional të administratës së sistemit gjyqësor, të cilat kryejnë detyra administrative dhe mbështetëse për zyrtarët e tjerë profesional. Puna kryhet brenda udhëzimeve, procedurave të cilat janë të detajuara dhe në mbikëqyrjen e eprorit ose zyrtarit të nivelit të lartë profesional.
2. Për fushat për të cilat është përgjegjës harton raporte për mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.
3. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunës i cili për punën e tij i përgjigjet mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.
4. Në kategorinë Profesional 3; Grupi J; Klasa J16, Koeficienti 5.3, bëjnë pjesë nëpunësit me emërtime të pozitës si vijon:

- 4.1. Recepcionist/Sekretariat dhe gjykatë;
- 4.2. Zyrtar Administrativ/Njësia;

- 4.3. Depoist/Sekretariat dhe gjykatë;
- 4.4. Zyrtar për Transport (Shofer)/Sekretariat/gjykatë/PZAP;
- 4.5. Zyrtar për Distribimin e Dokumenteve (dorëzues)/Sekretariat/gjykatë/PZAP.

Neni 19

Neni 29 i Rregullores bazë, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

Neni 29

Klasifikimi i vendeve të punës për kategorinë teknik dhe administrativ

1. Në kategorinë nëpunës teknik dhe administrativ është nëpunës i administratës së sistemit gjyqësor që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike.
2. Për fushat për të cilat është përgjegjës, harton raporte për mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.
3. Mbajtësi i kësaj pozite është nëpunës i cili për punën e tij i përgjigjet mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë sipas përshkrimit të vendit të punës.
4. Në emërtimin e pozitës: nëpunës/e teknik/e dhe administrativ/e, Grupi J, Klasa J17, Koeficienti 4.3, bëjnë pjesë nëpunësit e pozitës si vijon:
 - 4.1. Asistenti për Shërbime të Sigurisë (roje sigurimi)/gjykatë dhe degë;
 - 4.2. Asistent Teknik i Kontrollit dhe Mirëmbajtjes së objektit (shtëpiak dhe mirëmbajtës higjiene).

Neni 20

Në nenin 30 paragrafi 6 i Rregullores bazë, pas paragrafit 6.1, shtohet pozita me emërtimin e pozitës si në vijim:

- 6.2. Koordinator i Zyrës për Hulumtim, Publikim dhe Monitorim/Gjykatë Supreme, Grupi C, Klasa C6, Koeficienti 10.6.

Paragrafët sipas renditjes 6.2, 6.3 dhe 6.4 në rregulloren bazë, e ndryshojnë renditjen në 6.3, 6.4. dhe 6.5.

Neni 21

Neni 31, i Rregullores bazë, fshihet nga teksti.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj, nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ndërsa fillon së zbatuari nga data 1 janar 2026.

Albert Zogaj,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Datë:_____._____._____